



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1139/1 Prot.

Tiranë, më 22 / 07 / 2019

V E N D I M

Nr. 96 , Datë 22 / 07 / 2019

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 73, datë 23.05.2018, të paraqitur nga: T.F¹, M.F dhe E.Ç kundër Komisarariatit të Policisë Korçë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës” të shtetasit E.F. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, subjektet ankuese informojnë se ndaj djalit të tyre ishte ushtruar dhunë nga ana e punonjësve të policisë, që në momentin e shoqërimit në Komisarariat dhe se vdekja e tij kishte ndodhur pikërisht për këtë shkak. Ankuesit pretendojnë se policia me qëllim që të mbulonte ushtrimin e dhunës nuk i ka njoftuar për vdekjen e djalit të tyre. Ankuesit informojnë se për vdekjen e djalit të tyre janë vënë në dijeni në datë 17.05.2018, ditë kur ishte vendosur shqyrtimi i masës së sigurisë nga gjykata. Ankuesit shpjegojnë se nga persona të njohur janë lajmëruar për ngjarjen e vdekjes së djalit në mjediset e Komisarariatit dhe nëna e të ndjerit pas disa komunikimeve me punonjësit e policisë është paraqitur në morgun e spitalit dhe ka vërejtur se djali i saj kishte shenja dhune në trup deri në thyerje të krahut.

Subjektet ankuese, kërkojnë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që të dalë e drejta e vdekjes së djalit të tyre dhe personat përgjegjës të marrin dënimin e duhur.

¹ Ankuesit janë familjarë të të ndjerit E.F, anëtar i komunitetit Egjiptian, i cili në datë 17.05.2018, humbi jetën në njëren nga dhomat e sigurisë në Komisarariatit të Policisë Korçë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 73, datë 23.05.2018 të familjarëve të të ndjerit u konstatua se, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në informacionin e publikuar në datë 18.05.2018³ ka njoftuar për ngjarjet e ndodhura në Komisariatin e Policisë Korçë, në të cilën në mes të tjerash ka njoftuar se: *“Më datë 17.05.2018, jemi njoftuar se në dhomat e sigurisë në Komisariatin e Policisë Korçë, ka vdekur shtetasi E.F, 27 vjeç, banues në Korçë, i arrestuar në datë 14.05.2018, për veprën penale “Vjedhje me dhunë”. Nga kqyrja e trupit nuk janë konstatuar shenja dhune dhe nga informacionet paraprake dyshohet se viktimi, ka qenë përdorues i lëndëve narkotike. Grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorit, po punon për të përcaktuar shkaqet e vdekjes, si edhe për të kryer veprimet e nevojshme procedurale”.*

Për sa më sipër, në kushtet që kjo çështje ishte duke u hetuar pranë Prokurorisë Korçë, në mbështetje të nenit 66, pika 1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në të cilën parashikohet: *“Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje*

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

³(<https://www.asp.gov.al/index.php/17-shqip/lajmet-e-fundit/13726-informacion-mbi-ngjarjet-arrestimet-ndalimet-dhe-procedimet-ne-24-oret-e-fundit-18-maj-2018>)

ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me Vendimin nr. 136, datë 13.06.2018, pezulloi shqyrtimin e ankesës nr. 73, datë 23.05.2018, të T.F, M.F dhe E.Ç, deri në momentin që Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë të shprehej për çështjen në shqyrtim.

- Me shkresën nr. 737/1, datë 13.06.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ka sugjeruar institucionit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, që të hetojnë nëse veprimet e punonjësve të Komisarariatit të Policisë Korçë, kanë qenë të nxitura edhe nga motive racore.

Me shkresën nr. 3863, datë 19.06.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, informoi Komisionerin se: “Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë në datë 05.06.2018, ka rregjistruar procedimin penal nr. 649 të vitit 2018, për veprën penale “Mosdhënie ndihme” e parashikuar nga neni 97 i K.Penal. Në përfundim të hetimeve në lidhje me këtë procedim penal, do ju vëmë në dijeni për rezultatet e këtij hetimi”.

- Me shkresën nr. 716, datë 14.05.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga institucioni i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, informacion mbi rezultatit e hetimit për çështjen sipërcituar.

Me shkresën nr. 2828, datë 21.05.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, informoi Komisionerin se: “Lidhur me procedimin penal nr. 649 të vitit 2018, janë kryer veprimet hetimore nga ana e Prokurorisë dhe është paraqitur kërkesë në gjykatë për miratimin e pushimit të çështjes, në bazë të nenit 328/1, germa “b” i K.Pr.Penale, pasi fakti i ndodhur nuk përbënte veprë penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me Vendimin nr. 49, datë 05.03.2019, ka vendosur miratimin e kërkesës për pushimin e çështjes”.

Në këto kushte, pasi Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë u shprehën për çështjen dhe në mbështetje të nenit 68, pika 1/b të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilën parashikohet: “1. Vendimet e ndërmjetme përfundojnë automatikisht në rastet e mëposhtme: ...b) kur mbaron afati i caktuar në vendimin e ndërmjetëm”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vijoi me procedurën e mëtejshme të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezultoi se: E.F në datë 14.05.2018 është shoqëruar në mjediset e Komisarariatit të Policisë Korçë, me akuzë për veprën penale “Vjedhje me dhunë”. Në datë 17.05.2018, E.F, është gjetur i vdekur në njëren prej dhomave të Sigurisë të Komisarariatit të Policisë Korçë. Në datë 05.06.2018 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë ka nisur procedimin penal nr. 649, për veprën penale “Mosdhënie ndihme”.

Referuar Vendimit nr. 41-2019-885 (49 Prot.), datë 05.03.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në mes të tjerash rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë ka konstatuar se: *“Lidhur me pretendimet e ngritura nga familjarët, se ndaj të ndjerit është ushtruar dhunë, jo vetëm që nuk kanë rezultuar gjatë këqyrjes së kufomës, as në pjesën përshkruese të aktit të ekspertimit, as në tabelën fotografike të viktimës, por nga hetimi nuk rezulton asnjë indicie që ndaj të ndjerit të jetë ushtruar dhunë. Në të tilla kushte pretendimet e trashëgimtarëve të viktimës se ndaj E.F, është ushtruar dhunë fizike, nuk rezultojnë nga asnjë akt dhe provë të administruar në dosje. Gjithashtu dhe faktin tjetër që nuk i është dhënë ndihma mjekësore viktimës E.F para se ai të ndërronte jetë, ato ngelen në kuadrin e pretendimeve të tyre, pasi gjatë hetimit janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore dhe nga provat e administruara në dosje, të cilat janë analizuar me hollësi në pjesën arsyetuese të këtij vendimi nuk rezultoi asnjë e dhënë apo provë që të provonte se viktima kishte kërkuar ndihmë mjekësore dhe nuk i ishte dhënë⁴”.*

Në kontekst të sa më sipër dhe referuar këtij vendimi, Komisioneri vlerëson, se nuk ekzistojnë prova që të faktojnë se E.F është ekspozuar para një trajtimi të paligjshëm nga ana e Komisarariatit të Policisë Korçë, pasi referuar vendimit të sipërcituar nuk rezulton se ndaj të ndjerit E.F të jetë ushtruar dhunë.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në mungesë të një trajtimi të paligjshëm, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Komisarariatit të Policisë Korçë për shkakun e pretenduar nga ankuesit.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

⁴ Referuar Vendimit nr. 41-2019-885 (49 Prot.), datë 05.03.2019, faqe 8, paragrafi i fundit.

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të E.F nga ana e Komisarariatit të Policisë Korçë për shkak të “racës”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Robert GAJDA

KOMISIONER